

PROPOZIMET TEKNIKE PËR VOTËN E DIASPORËS

PROCESI I VOTIMIT

Ilirjan Celibashi
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve



**KOMISIONI QENDROR
I ZGJEDHJEVE**



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi





KQZShqiperi



kqz.gov.al

KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME



Elektronike +/ postë

Mënyra e propozuar e votimit

Periudha e votimit nga jashtë vendit


do të duhet të zgjasë disa ditë para datës së zgjedhjeve ‘brenda vendit’.

Votuesi do të ketë mundësinë të votojë disa herë deri në afatin e mbylljes së votimit.

Vetëm vota më e fundit në kohë do të numërohet.

Kjo mënyrë votimi është aplikuar në:
Estoni, Gjermani, Kanada, Australi (New South Wales), Francë, etj.

KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME



Për të hapur sesionin e votimit, votuesi akseson profilin e tij të krijuar gjatë regjistrimit.
Për të garantuar maksimalisht sigurinë e log-imit dhe identifikimit, sistemi do të përdorë **verifikimin me 3 faktorë**:

1 Teknologjinë FaceID Liveness

2 Fjalëkalimin personal, të krijuar pas regjistrimit
(të cilin ai e ndryshon vetë)


3 Kodin unik 6 shifror të përkohshëm

Kodimi i të dhënave të identitetit është tërësisht i ndryshëm në metodologji e parametra nga kodimi i votës, si dhe anasjelltas. Kjo e bën të pamundur lidhjen e votuesit me votën.




kqz.gov.al

SI VOTOHET



HAPI 1

Votuesi logs-in në llogarinë e tij sipas përshkrimit më lart. Sistemi kontrollon nëse këto të dhëna përputhen me ato të deklaruara gjatë krijimit të llogarisë.



Vendosni fjalëkalimin

Verifikimi
Vendosni kodin 6-shifror që morët me sms

Nuk morët kod? [Dërgo përsëri](#)



SI VOTOHET

HAPI 2

REPUBLICA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
FLETË VOTIMI
ZGJEDHJET PËR KRYETARIN E BASHKISË, 6 MARS 2022
Qarku Tiranë ZAZ Nr. 26
Bashkia Vorë QV: 1551.1_01

Zgjidh kandidatin

1	Kandidati 1 Partia/Koalicioni 1	<input type="checkbox"/>
2	Kandidati 2 Partia/Koalicioni 2	<input type="checkbox"/>
3	Kandidati 3 Partia/Koalicioni 3	<input checked="" type="checkbox"/>
Nuk zgjedh asnjë kandidat		<input type="checkbox"/>

VOTO

Votuesit i shfaqet fleta elektronike e votimit

HAPI 3

REPUBLICA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
FLETË VOTIMI
ZGJEDHJET PËR KRYETARIN E BASHKISË, 6 MARS 2022
Qarku Tiranë ZAZ Nr. 26
Bashkia Vorë QV: 1551.1_01

JU KENI ZGJEDHUR
KANDIDATIN 3

Ndrysho zgjedhjen nëse dëshiron

PËRFUNDO VOTIMIN

Për tu siguruar se vullneti i votuesit nuk është cënuar, atij i kërkohet të konfirmojë zgjedhjen që ka bërë ose të kthehet pas e të bëjë zgjedhjen që kishte qëllim të bënte.

Paraqitja e fletës elektronike të votimit do të jetë e përshtatshme me çdo pajisje personale: laptop, tabletë, pc, telefon celular.



kqz.gov.al


SI VOTOHET

HAPI 4



Pasi ka konfirmuar zgjedhjen e tij, në pajisjen ku kreu procesin e votimit, votuesit i shkarkohen **2 QR Kodet**

HAPI 5



Votuesi mund të dërgojë QR kodet në KQZ:

- **elektronikisht;**
- ose
- **i printon dhe i dërgon me postë** në adresën fizike të KQZ (zarf brenda zarfit, secili i mbyllur)

* në të dy rastet, votuesi do të njoftohet në llogarinë e tij **a.** kur vota të mbërrijë në KQZ (konfirmim të marrjes të votës elektronikisht dhe/ose të mbërritjes së zarfit të postës në KQZ) dhe **b.** kur QR kodi/vota i tij është printuar.



QR kodi i parë që lidhet me identitetin e votuesit përmban informacionet si më poshtë

Emri: XXXXXXX
 Mbiemri: YYYYYY
 Datelindja: DD / MM / VVVV
 Adresa: Aaaa, Bbbbb, Cccccc, Dddddd
 Gjinia: X
 QV numer: XXXX ,
 ZAZ numer: YYY ,
 Qarku: ZZZZZZ
 Numri rendor ne liste votimit: XXX

Data ora e votimit: DD / MM / VVVV hh:mm:ss
 Te dhena teknike nga pajisja e perdorur nga votuesi: IP, Geolocation, device model, OS name, device daytime.

Informacioni më sipër kodohet si më poshtë:

ed60249e8612ab69af17df2e99eae0bc09f7879d606f0d561a39494b44700d920c322 3e3b2e214579f4be525c549d1312c4d2462794dea6e939b801d05c0df81

Kjo metodologji kodimi është unike vetëm për pjesën e identitetit të votuesit.

*Kodi më sipër është për efekt demonstrimi dhe nuk përfaqëson kodimin real që do të përdoret.



Kodimi më sipër konvertohet në QR, për lehtësi leximi më pas gjatë procesit të numërimit (nëpërmjet skanerave të QR code) për të garantuar saktësinë dhe shmangur gabimet njerëzore

QR kodi i dytë që lidhet me votën/zgjedhjen përmban informacionet si më poshtë

Partia: AAAAA
 Kandidati: BBBBB

Pjesa e votës përmban vetëm informacionin si në figurën më sipër dhe asnjë informacion tjetër as mbi identitetin e votuesit dhe as mbi kohën kur votoi.

Informacioni më sipër kodohet si më poshtë:

cee3f0370a8dbc0a782739e40d943aed379668c284e7666edae4886e14aa2ef28695 99fc5357e31f71a0cf31cead2fb7570aa29e3f296a8cfd98e3ca56640873


Kjo metodologji kodimi është unike vetëm për pjesën e identitetit të votuesit.

*Kodi më sipër është për efekt demonstrimi dhe nuk përfaqëson kodimin real që do të përdoret.




Kodimi më sipër konvertohet në QR, për lehtësi leximi më pas gjatë procesit të numërimit (nëpërmjet skanerave të QR code) për të garantuar saktësinë dhe shmangur gabimet njerëzore


ÇFARË NDODH NDËRKOHË BRENDË SISTEMIT QENDROR GJATË PROCESIT TË VOTIMIT



Sistemet në KQZ që do të dekodojnë këto dy QR kode:
do të jenë tërësisht të shkëputura nga çdo rrjet kompjuterik,
si dhe tërësisht të shkëputura nga njëra-tjetra.
Do të jenë offline.



Ato do të **aksesohen vetëm fizikisht 'on-site'** nga personeli i KQZ.



Stafi i KQZ do të ketë kode të shumëfishta për të garantuar që **procesi i dekodimit fillon vetëm pasi të gjithë pjesëmarrësit në proces e kanë dhënë aprovimin**. Kodi i dekodimit **ndahet në fraksione/pjesë midis disa komisionerëve** (kodi është i plotë vetëm nëse bashkohen të gjithë pjesët).




Sistemi e për pasojë edhe stafi që do të dekodojë pjesën e identitetit të votuesit nuk mund të dekodojë votën, si dhe anasjelltas.



kqz.gov.al

NUMËRIMI NË KQZ I VOTAVE TË ARDHURA ME POSTË



Me të mbërritur në KQZ, me postë, kodet që g jenden në zarfa të ndarë **ndahen fizikisht në dy ambiente të ndryshme** ku përpunohen nga staf i ndryshëm.


HAPI 1



QR1

Dekodohet vetëm QR kodi mbi identitetin e votuesit.
Leximi do të bëhet me një skaner QR kodi.

HAPI 2



KQZ menjëherë pas leximit të QR për identitetin e votuesit, përmes sistemit e njofton votuesin se vota e tij/saj ka arritur në KQZ dhe do të numerohet në datën dhe orën e përcaktuar.


HAPI 3

NUMËRIMI NË KQZ I VOTAVE TË ARDHURA ME POSTË




Ndërkohë në dy ambientet e ndara, **njëri grup numëron QR kodet e identitetit** duke përcaktuar kështu sa është pjesëmarrja dhe sa vota pritet të numërojnë grupi tjetër.

HAPI 4



Numërimi i votave kryhet në mjedis të izoluar, që nuk është i lidhur me asnjë rrjet të jashtëm kompiuterik dhe as me sistemin e dekodimit të identitetit të votuesit.

HAPI 5




Numërimi i votave fillon **vetëm pasi të paktën dy/tre (apo më shumë)** komisionerë të caktuar nga KQZ të konfirmojnë fillimin e numërimit me kodet e tyre unike të dekodimit të gjeneruar nga sistemi qendror.

HAPI 6



NUMËRIMI NË KQZ I VOTAVE TË ARDHURA ME POSTË




QR2

Leximi i QR kodit të votës do të kryhet me anën e një skaneri QR.

Sistemi do të dekodojë pjesën e koduar përkatëse dhe do të lexojë 'zgjedhjen'.

HAPI 7



Partia 1	x vota
Partia 2	xxx vota
Partia 3	xx vota

Sistemi do të numërojë automatikisht secilën votë

dhe do të plotesojë tabelën e rezultateve për secilën zonë/qark/njësi votimi (siç do të përcaktohen nga kuadri rregullator).

HAPI 8



kqz.gov.al

NUMËRIMI NË KQZ I VOTAVE TË ARDHURA ELEKTRONIKISHT



Me të mbërritur në adresën postare elektronike të KQZ (sistem), **automatikisht sistemi e njofton votuesin** se vota e tij/saj është dërguar me sukses në KQZ dhe do të numerohet në datën dhe orën e përcaktuar.

HAPI 1



#votues

Sistemi konstaton **sa është pjesëmarrja** për shkak të verifikimit që votat elektronike të ardhura kanë certifikatën e sigurisë përkatëse si dhe enkriptimin e njohur nga sistemi.

HAPI 2




Pas këtij hapi, operatori që menaxhon këtë sistem 'pritjeje', **printon QR kodet e ardhura në sistem/votat elektronike** të cilat nuk kanë asnjë të dhënë që lidhet me timestamp-in ose të dhëna të tjera identifikuese. Sistemi replikon elektronikisht parimin 'me dy zarfa të ndarë, të mbyllur'.

HAPI 3



kqz.gov.al

NUMËRIMI NË KQZ I VOTAVE TË ARDHURA ELEKTRONIKISHT



Ndërkohë **në një ambient të ndarë nga sistemi pritës më përpara**, një grup grumbullon pret të fillojë numërimin e QR kodeve të votave. Ky mjedis nuk është i lidhur me asnjë rrjet të jashtëm kompjuterik.

HAPI 4




Numërimi i votave fillon **vetëm pasi të paktën dy/tre (apo më shumë)** komisionerë të caktuar nga KQZ të konfirmojnë fillimin e numërimit me kodet e tyre unike të dekodimit të gjeneruar nga sistemi qendror.

HAPI 5



kqz.gov.al

NUMËRIMI NË KQZ I VOTAVE TË ARDHURA ELEKTRONIKISHT




QR2

Leximi i QR kodit të votës do të kryhet me anën e një skaneri QR.

Sistemi do të dekodojë pjesën e koduar përkatëse dhe do të lexojë 'zgjedhjen'.

HAPI 6



%

Partia 1	x vota
Partia 2	xxx vota
Partia 3	xx vota

Sistemi do të numërojë automatikisht secilën votë dhe do të plotësojë tabelën e rezultateve për secilën zonë/qark/njësi votimi (siç do të përcaktohen nga kuadri rregullator).

*koha e numërimit të votave të ardhura me postë me ato të ardhura elektronikisht fillon e mbaron në të njëjtën kohë.

HAPI 7

KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME PËR NUMËRIMIN



Sistemi do të garantojë që vota e votuesit të numërohet vetëm një herë, edhe nëse votuesi mund ta ketë dërguar votën disa herë me postë ose edhe elektronikisht.



Sistemi do të garantojë pamundësinë për të lidhur momentin e kohës të votave të ardhura me postë ose elektronikisht me sistemin e numërimit të votave duke hequr çdo timestamp për të eliminuar kështu çdo lidhje me votuesin.



Sistemi do të garantojë sekretin e votës ndaj përdoruesve të sistemit, administratorëve të sistemit dhe audituesve potencial.

Propozimet Teknike për Votën e Diasporës
Procesi i Votimit

Faleminderit !



**KOMISIONI QENDROR
I ZGJEDHJEVE**

